



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 62, datë 24.05.2021

PËR

**MIRATIMIN E RIALOKIMIN E FONDIT PREJ 372'080 LEKË PËR SHËRBIMIN NË FAMILJE PËR FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË MOSHËS 2-6 VJEC, TË CILAT BASHKIA I KA PËRFITUAR NGA PROGRAMI I PËRBASHKËT I KOMBEVE TË BASHKUARA, "ASKUSH TË MOS MBETET PAS", ZBATUAR NGA UNDP**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", Ligjit nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.4, datë 25.01.2021 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021", VKB Nr.123, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023", VKB Nr.105, datë 30.10.2020 "Për miratimin e përdorimit të fondit 995'000 lekë për shërbimin në familje për fëmijët me aftësi të kufizuara të moshës 2-6 vjec, të cilin bashkia e përfiton nga programi i Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas" zbatuar nga UNDP, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**


1. Miratimin e rialokimit të fondit prej 372'080 lekë përfituar nga programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas" zbatuar nga UNDP, i ndarë si më poshtë:
  - Blerje kompjutera (Artikulli 231) në vlerën 95'000 lekë.
  - Shpenzime operative (Artikulli 602) në vlerën 277'080 lekë.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimit Social .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 24.05.2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 369 / prot.  
3

Durrës, më 27.05.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 62 datë 24.05.2021 “Për miratimin e rialokimit të fondit prej 372’080 lekë për shërbimin në familje për fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës 2-6 vjeç, të cilat Bashkia i ka përfituar nga programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, “Askush të mos mbetet pas”, zbatuar nga UNDP”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

